



Përkushtimi i Ipsos ndaj Privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave

Konteksti

Rregullorja e përgjithshme e mbrojtjes së të dhënave e lëshuar nga Bashkimi Europian (“GDPR”) dhe hyrë në fuqi në 25 Maj, 2018, është një hap i mëtejshëm evolucionar në mbrojtjen e të drejtave të privatësisë së individëve (për shembull, kufizime të forta rreth pëlqimit, të drejtën për tu harruar, llojin dhe sasinë e të dhënave personale që mund të përdoren, aksesit i të dhënave dhe siguria, etj.), përtej mbrojtjeve që janë tashmë prej kohësh në Bashkimin Europian dhe në shumë vende të tjera të botës.

Si pasojë, mbrojtja e të dhënave personale është, dhe gjithmonë ka qenë, prioritet kryesor për Ipsos si një lider në industrinë e Studimit të Tregut dhe prodhues informacioni për njerëzit. Ipsos është i përshtatur me drejtimin dhe kërkesat e kodit profesional të sjelljes të aplikueshme për të gjitha kompanitë e regjistruara të studimit të tregut (ICC/ESOMAR Kodi Ndërkombëtar për Tregun, Opinionin dhe Kërkimin Social dhe analizën e të dhënave¹) dhe të gjitha rregulloret ekzistuese të momentit, posaçërisht për ndjeshmërinë e mbrojtjes së të dhënave të respondentëve.

Gjithashtu për shumë vjet, Ipsos ka adoptuar qasjen e 4S-ve në biznesin e vet. 4S-të nënkuptojnë Siguri, Simplicity, Shpejtësi dhe Substancë, me politikën e Menaxhimit të siguri të IT dhe Informacionit që janë një pjesë integrale e politikave të Ipsos për shumë vjet. Ipsos mori një qasje proaktive për të siguruar ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale të klientëve të vet, respondentëve dhe punonjësve. Për këtë qëllim, vjet, Ipsos lançoi një program global privatësie, të drejtuar nga një skuadër multi-disiplinare (p.sh., nga departamentet e veta të CPO, IT, Ligjore, të Cilësisë, Burimeve Njerëzore dhe Marketingut & Komunikimit), për të punuar në arritjen e objektivave deri në 25 Maj 2018, duke u fokusuar fillimisht në vendet e BE-së. Për më tepër, nga fundi i vitit 2018, Ipsos ka si qëllim që të implementojë gjithashtu kërkesat e GDPR në të gjitha 89 shtetet ku vepron.

Ipsos ka ndërmarrë tashmë shumë veprime në përputhje me GDPR; me disa nga veprimet kryesore që përfshijnë të mëposhtmet:

1. Emërimin e një oficeri kryesor global të Privatësisë(CPO) dhe oficerët e të dhënave lokale të Privatësisë (DPOs).

Në 1 Mars 2017, Ipsos caktoi një oficer kryesor global të Privatësisë, Mr. Rupert van Hüllen.

Roli i oficerit është të drejtojë dhe të koordinojë përpjekjet globale të pëlqimit të Ipsos mbi mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë dhe të menaxhojë oficerët vendorë të Mbrojtjes së të Dhënave që janë caktuar për çdo shtet në të cilin Ipsos vepron. Mandati i tyre është që të sigurojë që të dhënat personale janë trajtuar dhe mbrojtuar siç duhet.

2. Të dhënat anonime dhe siguria e aksesit

- Për respondentët

Ipsos përdor teknika anonimiteti për të mbrojtur të dhënat personale të respondentëve si pjesë të veprimeve të mbledhjes së të dhënave që aksesit të jetë i kufizuar në ekipet e veta të punës në terren në njësitë e veta të veprimit vetëm në rastet kur duhet. Ipsos aplikon të njëjtën politikë dhe kujdesje për kampionimet e siguruara për klientët dhe për panelistët online të Ipsos dhe off-line respondentët.

¹ ICC/Esomar International Code on Market, Opinion and Social Research and Data Analytics (<https://www.esomar.org/what-we-do/code-guidelines>)



- Për punonjësit tanë

Aksesi në të dhënat personale të punonjësve është shumë i kufizuar për stafin e përshtatshëm në ngarkim të menaxhimit të burimeve njerëzore.

3. Trajnimi i punonjësve

Ipsos do të lançojë një program gjithëpërfshirës trajnimi të punonjësve në Mars - Prill 2018 për të siguruar një nivel të lartë ndërgjegjësimit në zbatim të mbrojtjes së të dhënave në grupin Ipsos. Klientët tanë presin që punonjësit e Ipsos të jenë në përputhje me standartet GDPR dhe legjislacionet e tjera të mbrojtjes së të dhënave të aplikueshme. Ipsos është duke implementuar një program botëror trajnimi në lidhje me mbrojtjen e të dhënave (duke përfshirë kërkesat e GDPR) për stafin e përshtatshëm.

4. Kriptimi (procesi i konvertimit të të dhënave në 1 kod, për të parandaluar aksesin e paautorizuar)

Ipsos implementoi zgjidhje të ndryshme kriptimi, sidomos në të gjitha laptopet e punonjësve. Në lidhje me aplikacionet/softueret e veta, Ipsos po merr masa për të kriptuar aplikacione të caktuara paneli si dhe databaza që përmbajnë kategori të veçanta (sensitive), të të dhënave personale, si dhe të dhëna në lidhje me shëndetin, opinionet politike, etj.

Së fundmi, kur vjen puna te punonjësit e vet, sistemi kryesor kapital i menaxhimit human të Ipsos, i quajtur "iTalent," është plotësisht i kriptuar.

5. Furnitorët

Ipsos siguron procedurat në mënyrë që të përzgjedhë procesimin e të dhënave personale bazuar në kapacitetin e përshtatjes me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave të Ipsos. Kjo do të thotë që të gjithë furnitorët duhet të firmosin një marrëveshje me Ipsos ku përfshihet klauzola e mbrojtjes së të dhënave, aq strikte sa ato që Ipsos firmos me klientët e vet, dhe që asnjë furnitor të mos transferojë asnjë të dhënë personale jashtë derisa ata të bien dakort të marrin masa mbrojtëse të përshtatshme dhe miratimin e klientit. Përveç kësaj, furnitorët tanë nuk mund të nënkontraktjnë pjesë të shërbimit të procesimit të të dhënave personale te nën-kontraktorët pa aprovimin paraprak të Ipsos.

6. Transferimi i të dhënave

Ipsos vendos disa masa kontraktuale për transfertat e të dhënave jashtë shtetit brenda Ipsos dhe me furnitorët e vet. Kur kërkohet një transferim të dhënash në një shtet të njohur për mospasjen e një niveli të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave, Ipsos siguron që Klauzolat Standarte Kontraktuale të BE-së, të jenë funksionale, duke implementuar masat e përshtatshme teknike dhe organizacionale për mbrojtjen e të dhënave personale. Ipsos mbetet i vendosur në mbrojtjen e të dhënave personale për klientët e vet, respondentët dhe punonjësit. Nëse keni ndonjë pyetje ose kërkoni sqarime të mëtejshme, ju lutem kontaktoni Oficerin tonë Kryesor të Privatësisë, Rupert van Hullen, që do të drejtojë pyetjet tuaja tek personi i përshtatshëm.



GAME CHANGERS

« Game Changers » is the Ipsos signature.

At Ipsos we are passionately curious about people, markets, brands and society.
We make our changing world easier and faster to navigate and inspire clients to make smarter decisions.
We deliver with security, simplicity, speed and substance. We are Game Changers.

Ipsos is listed on Eurolist - NYSE-Euronext.
The company is part of the SBF 120 and the Mid-60 index
and is eligible for the Deferred Settlement Service (SRD).

ISIN code FR0000073298, Reuters ISOS.PA, Bloomberg IPS:FP
www.ipsos.com